



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:253732

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05826936

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Driton Sadiku, me praktikanten e gjykatës Vlera Saliuka, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK-së), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/IL.nr.120/2023, të datës 20.02.2024, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datën 28.05.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit, Azem Islamaj, si dhe të akuzuarit, me datën 30.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 14.06.2024 e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. B., nga i ati A., e ëma V., e vajzërisë H., data e lindjes . . ., në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën “. . .”, hyrja te Mobil Shop “. . .”, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, punon në zdrukthëtari, i gjendjes së mesme ekonomike, egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 15.08.2023, rreth orës 22:30 minuta, në rr.“. . .”, në Gjakovë, tek shëtitorja e lumit “. . .”, në afërsi të Hotelit “. . .”, duke vepruar në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit Nr.02/L-128 për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit “Marihuanë”, në atë mënyrë që ditën kritike hetuesit e DHTN-së, gjatë zbatimi të planit operativ “Goditja 2023”, me te ndalua të pandehurin dhe

gjatë kontrollit të tij, në xhepin e pantallonave i janë gjetur dy qese najloni të mbushura me substancë narkotike të llojit “Marihuanë”, ndërsa gjate kontrollit rreth karriges ku ishte i ulur i njëjti, i është gjetur një cigare (Joint) e mbushur me substancë narkotike të llojit “Marihuanë”, të cilat sekuestrohen nga ana e zyrtarëve policor, ku pas ekzaminimit laboratorik të narkotikut rezulton të jetë Kanabis (Marihuan), që përmban Tetrahidrolkanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme 1.4 gram.

- me këto veprime ka kryer veprë penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 269 par.2 të Kodit Penal të Kosovës, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej treqind (300.00) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimin me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga njëzet (20) euro.
- III. Ndaj të akuzuarit KONFISKOHET substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshën e përgjithshme prej 1.40 gram dhe URDHËROHET Stacioni Policor në Gjakovë që pasi që ky aktgjykim të marr formën e prerë të bëjë shkatërrimin e të njëjtës e cila në polici evidentohet me numrin e rastit 2023-EA-1158.
- IV. Detyrohet i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.120/2023, të datës 20.02.2024, ndaj të akuzuarit M. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 28.05.2024 në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Azem Islamaj, si dhe i akuzuari M. B.. Gjatë shqyrtimit fillestar prokurori i shtetit ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se; e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, shton se kam gabuar, nuk kam përdorur më narkotikë, tani jam martuar, jam duke punuar, si dhe jam duke pritur që të bëhem baba, për këtë i kërkoi falje gjykatës, familjes dhe gruas time të cilës i kam krijuar stres dhe premtoi se nuk do të përsërisë më ndonjë vepër penale.

Prokurori i Shtetit, Azem Islamaj, duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se; nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së bërë nga i pandehuri, meqenëse ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe atë pas njoftimit nga gjykata mbi pasojat dhe benifitet të cilat krijohen nga pranimi i fajësisë, si dhe për faktin se ky pranim i fajësisë gjen mbështetje në provat që i janë bashkëngjitur kësaj aktakuze. Kërkoj nga gjykata që me rastin e matjes së dënimit të merren parasysh rrethanat lehtësuese si dhe ato rënduese e që specifikuhen si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merret shkalla e lartë e dashjes së të njëjtit, si dhe fakti se i njëjti nuk është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ashtu që pas vlerësimit të këtyre rrethanave duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë së të njëjtit, gjykata ta shpallë fajtor ta dënoi sipas ligjit si dhe ta obligoi në pagesën e shpenzimeve procedurale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale

për të cilën është ngarkuar me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shteti dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari M. B., me dashje ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 269 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge: “ *Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet*”, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë forma e privilegjuar e kësaj vepre ku përcaktohet se “ *Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotrope ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*”

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin M. B. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2

të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethana lehtësuese që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana: rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është i moshës relativisht të re, është martuar dhe është në pritje që të bëhet baba, gjendjen e tij të dobët ekonomike, ku nga familja shtatë anëtarësh, punojnë vetëm i akuzuari dhe nëna e tij dhe me të ardhurat që realizojnë kujdesën për familjen; sjellja e tij ka qenë tejet korrekte me gjykatën duke shprehur pendim për veprën e kryer; i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris më ndonjë veprë penale, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet.

Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar rrezikshmërinë - vlerën e mbrojtur shoqërore, pasi që veprat penale të narkotikut, gjithnjë e më shumë po shkojnë drejt trendit të rritjes, ku trendi i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj veprë penale, me të cilën cenohen edhe vlerat më të mbrojtura shoqërore, përkatësisht jeta dhe shëndeti i qytetarëve, posaçërisht ku përdorues të narkotikut janë grup-moshat e reja si vlerë e rëndësishme e shoqërisë; si dhe faktin se i njëjti edhe më parë në këtë gjykatë është dënuar sipas aktgjykimit me numër 2024:065785 të datës 16.04.2024, për veprën penale dhunë në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, për të cilën e ka pranuar fajësinë.

Kështu që nga rrethanat e lartpërmendura gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuara dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për konfiskim

Duke u bazuar në nenin 269 par.3 të KPRK, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që ndaj të akuzuarit M. B. i të konfiskohen substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshën e përgjithshme prej 1.40 gram, si objekt i kryerjes së veprës penale dhe më pas ka urdhëruar Stacioni Policor në Gjakovë që pasi që ky aktgjykim të marr formën e prerë të bëjë shkatërrimin e substancës narkotikë të konfiskuar.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa për taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimin duke u bazuar në nenin 36 par.3 nën par.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2023:253732, me datën 14.06.2024

Praktikantja e gjykatës,
Vlera Saliuka

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Driton Sadiku

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.